



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 4669/11 Prot

Tiranë, më 3.9.2020

**UDHËZIM**

Nr. 22 datë 3.9.2020

**PËR**

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020 “PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 30 dhe 35 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, vendimit nr. 418, datë 10.05.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”,

**U D H Ë Z O J:**

I. Në udhëzimin nr.1, datë 14.1.2020 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Kudo në udhëzim, togfjalëshi “...në sistemin elektronik/në sistemin elektronik përkatës /pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vijim MASR...”, zëvendësohet me togfjalëshin “në platformën e-Albania”.
2. Kudo në udhëzim, togfjalëshi “...dhe depoziton në mënyrë shkresore pranë MASR...” dhe togfjalëshi “...dhe depoziton/jnë në formë/mënyrë shkresore”, shfuqizohen.
3. Kudo në udhëzim, togfjalëshi “...sipas shtojcës nr.1 të këtij udhëzimi/sipas shtojcës nr. 1...” dhe “...sipas shtojcës nr. 2...”, zëvendësohen me togfjalëshin “...sipas formularit përkatës në platformën e-Albania.”.

4. Pika 1 dhe 2, e Kreut I/A ndryshojnë si më poshtë:

*“1. Subjekti juridik vendas ose i huaj aplikon online në platformën e-Albania, duke plotësuar formularin për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, brenda datës 15 maj për vitin e dytë akademik pasardhës.*

*2. Mbi bazën e aplikimeve në platformën e-Albania, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vijën MASR, brenda një afati 30 ditor nga data e aplikimit, njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.”.*

5. Në fund të shkronjës “b”, të pikës 3.2, të Kreut I/A, shtohet fjalia me përmbajtjen si më poshtë:

*“Kolegjet profesionale të larta, departamentet e të cilave kanë programe studimi që zgjasin dy vite akademike, me 120 kredite (ECTS), kanë, të paktën, dy pedagogë me gradë shkencore ose titull akademik për çdo departament. Departamenti mund të ketë në përbërje edhe personel ndihmës mësimdhënës.”.*

6. Në shkronjën “a”, të pikës 4, të Kreut I/A dhe I/B, fjalët “...në MASR”, zëvendësohen me togfjalëshin “...në platformën e-Albania”.

7. Në kreun IV, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) Në pikën 3/B, pas shkronjës “e”, shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

*“f) Mandotpagesën për tarifën që paguhet për vlerësimin nga ekspertët e programit të studimit, sipas përcaktimeve në VKM nr. 109/2017, i ndryshuar.”.*

- b) Shkronja “a”, e pikës 1/C, ndryshon me këtë përmbajtje:

*“a) IAL-ja aplikon në platformën e-Albania sipas formularit përkatës, për mbylljen e programit/eve të studimit, jo më vonë se 6 muaj para fillimit të vitit të ri akademik. Subjekti ngarkon kërkesën e argumentuar, shoqëruar me propozimet e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, si dhe vendimet përkatëse të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit. IAL-ja është përgjegjëse për pasojat juridike të ardhura nga mbyllja e programit/eve të studimit për studentët që kanë përfunduar programin apo janë në proces ndjekjeje të programit.”.*

8. Në kreun VI, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) Pika 4, ndryshon, si më poshtë:

*4. Për aplikimet në platformën e-Albania për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve të tyre dhe hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit, zbatohen rregullat e këtij udhëzimi, me hyrjen në fuqi të tij. Aplikimet për hapjen, riorganizimin, mbylljen e njësisë kryesore, mbylljes së degës së IAL-së, si dhe*

për bashkimin dhe ndarjen e IAL-ve, do të vijojnë të bëhen në adresën elektronike [aplikime.ial@arsimi.gov.al](mailto:aplikime.ial@arsimi.gov.al), deri në procedimin e tyre nëpërmjet platformës e-Albania.”.

b) Pas pikës 5, shtohen pikat 5/1 dhe 5/2 me këtë përmbajtje:

“5/1. MASR mund të kërkojë që një ose më shumë dokumente të ngarkuara elektronikisht, të dorëzohen edhe në formë shkresore nga subjekti aplikues.”.

“5/2. Struktura përgjegjëse në MASR mban procesverbalin përkatës për çdo dokumentacionin të depozituar në platformën e-Albania.”.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**MINISTRI**  
  
**Besa SHAHINI**  
